



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA KORÇË**



Nr. \_\_\_\_ Prot

Korçë, më 15.10.2024

### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT (paraparak)

Date 15.10.2024

Drejtuar: *Shoqërisë “ASI INVEST”sh.p.k adresa: Tiranë, Rruga Xhorxhi Martini, Pallati 17, Ap.5, Hyrja 5*

Procedura e prokurimit: **Procedure e hapur**

Numri i procedurës **REF-18957-09-12-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës :

Objekti: **“Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit të Gjonomadhit”**

Ky objekt është parashikuar të financohet nga buxheti i shtetit sipas VKM Nr 306 date 22.05.2024 .  
Fondet nuk trashëgohen në vitin pasardhës.

Afati: **2 muaj**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : **Nr. 60, Date 16.09.2024.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

**oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. Bashkimi i operatoreve “ VILDEV-CO ”shpk, NIPT K83926001F & “ A.L-ASFALT ” shpk, NIPT K81511508A me vleren:**

*6.063.595 ( gjashtë milion e gjashtedhjetë e tre mijë e pesëqind e nentëdhjetë e pese ) lekë pa tvsh  
Vlera pas korigjimit*

**2. Shoqëria “ REJ ” shpk, NIPT J93711608Q me vleren:**

7.965.038,55 (shtatë milion e nenteqind e gjashtedhjetë e pesë mijë e tridhjetë e tete, presje pesedhjetë e pesë)lekë, pa tvsh.

**3. Shoqëria “ I.C.C GROUP ” shpk, NIPT L51308006A me vlerën:**

7.978.785 (shtatë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtateqind e tetëdhjetë e pesë ) lekë, pa tvsh.

**4. Shoqëria “ NIKA ” shpk, NIPT J76705047U me vlerën:**

8.285.742,78 ( tete milion e dyqind e tetedhjetë e pesë mijë e shtateqind e dyzet e dy, presje shtatedhjetë e tete)lekë, pa tvsh.

**5. Shoqëria “ ASI INVEST shpk, NIPT M01927023H me vlerën:**

8.993.999 (tete milion e nenteqind e nentedhjetë e tre mijë e nenteqind e nentedhjetë e nente)lekë, pa tvsh.

**6. Shoqëria“RSM COMPANY” shpk me Nr Biznesi 810802422 me vlerën:**

9.124.396 (nente milion e njeqind e njezet e kater mijë e treqind e nentedhjetë e gjashtë)lekë, pa tvsh.

**7. Bashkimi i operatoreve “ INFINIT ” shpk, NIPT J74304623M, dhe “ L.T.E CONSTRUCTION ” shpk, NIPT L78006801F me vlerën:**

9.444.081 (nente milion e katerqind e dyzet e kater mijë e tetedhjetë nje) leke, pa tvsh

**8. Shoqëria “ SARK ” shpk, NIPT K52531415H me vlerën:**

9.606.646,35 (nente milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e dyzet e gjashtë, presje tridhjetë e pesë) leke, pa tvsh

**9. Shoqëria “FLED” shpk, NIPT K17621104C me vlerë:**

9.659.479,20 ( nente milion e gjashtëqind e pesedhjetë e nente mijë e katerqind e shtatedhjetë e nente,presje njezet) leke, pa tvsh

**10. Shoqëria “ ARTYKA II ” shpk, NIPT K26625603U me vlerën:**

9.713.660,25 (nente milion e shtateqind e trembedhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë, presje njëzet e pesë) leke, pa tvsh

**11. Shoqëria “ AVDULI ” shpk, NIPT J66703306O me vlerën:**

9.953.614 (nente milion e nenteqind e pesedhjetë e tre mijë e gjashtëqind e katermbedhjetë) leke, pa tvsh

**12. Shoqëria “ XHENGO ” shpk, NIPT J64103171M me vlerën:**

11.432.162 (njembedhjetë milion e katerqind e tridhjetë e dy mijë e njeqind e gjashtedhjetë dy) leke, pa tvsh

**13. Shoqëria “ ERGI ” shpk, NIPT K02727229P me vlerën:**

12.486.421,5 (dymbedhjetë milion e katerqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e katerqind e njezet e nje, presje pesë) leke, pa tvsh

**14. Shoqëria “ INA” shpk, NIPT J61814009W me vlerën:**

12.697.497 (dymbedhjetë milion e gjashtëqind e nentedhjetë e shtate mijë e katerqind e nentedhjetë e shtate) leke, pa tvsh

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. Bashkimi i operatoreve “ VILDEV-CO ”shpk, & “ A.L-ASFALT ”shpk, per arsye se:**

1.Sipas kontrates te bashkepunimit te lidhur ndermjet shoqerive,shoqeria “Vildev Co”sh.p.k ka marre persiper 49% te punimeve dhe shoqeria “A.L -ASFALT” sh.p.k ka marre persiper 51% te punimeve. Nga ofertuesi nuk

jane paraqitur punimet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri ne menyre qe te gjykohet per permbushjen e kriterëve nga secili prej anetareve te bashkimit, sipas parashikimeve te nenit 88 te VKM 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

2. Ne oferten e paraqitur nga ofertuesi rezultoi **se eshte bere gabim aritmetik** gjate mbledhjes te nentotaleve.

**Mbas korrjimit** te gabimit, vlera totale e ofertes rezulton **6.063.595** (gjashte milion e gjashtedhete e tre mije e peseqind e nentjedhete e pese) lek, pa tvsh, nderkohe qe vlera e ofertes e ofruar nga ofertuesi ne formularin e ofertes eshte 7.580.635 lek, pa tvsh.

Për sa më sipër ofertuesi skualifikohet bazuar ne nenin 82 pika 3 të VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ku përcaktohet shprehimisht se: "Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: - shumat absolute të të gjitha korrjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.

## **2. Shoqeria "REJ" shpk, per arsye se:**

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, mbas verifikimit të ofertave beri llogaritjet per te percaktuar nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit dhe ne nenin 82 pika 4 të VKM 285 date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik ku përcaktohet se "Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme."

Mbas llogaritjeve te bëra u konstatua se oferta juaj eshte me cmim anomalisht te ulët dhe ne keto kushte oferta refuzohet bazuar ne nenin **93 pika 5 e Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me Ligjin Nr nr. 16/2024, datë 08.02.2024 ku përcaktohet se:**

*Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i s'kualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.*

## **3. Shoqeria "I.C.C GROUP" shpk, per arsye se:**

1-Nje pjese e stafit dhe mjeteve jane te anagazhuara ne kontraten me objekt "Rehabilitimi i Qendrës Rinore Korçë" te lidhur me Bashkine Korce, e cila eshte duke u zbatuar aktualisht.

Konkretisht: Znj.O. L.,Z.E.Z,mjetet AA 432EB, AA 682 AS.

Si rrjedhim nuk permbush kriteret 2.2.3 dhe dhe 2.2.6 te dokumentave te tenderit

## **4. Shoqeria "NIKA" shpk, per arsye se:**

1-Stafi eshte i anagazhuar ne kontratat me objekt "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazhi" Korçë" dhe "Ndertim Lere Plasmasi "Sheshi i Rungajës","Deko", "Sheqe" dhe "Pandelimoni", Ekonomia Kullosore Rungajë"

Fuqia punetore ne total eshte e angazhuar ne objektet e mesiperme . Gjithashtu Znj.Gentiana Mosko eshte deklaruar si drejtuese teknike tek objekti "Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Sevasti Qiriazhi" cka bie ne kundërshtim edhe me udhezimin Nr.2, date 13.05.2005, Kreu I, pika 2.1, paragrafi 2, ku citohet se: "Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi".

Si rrjedhim nuk permbush kriteret 2.2.3 ,2.2.4, 2.2.5 dhe 2.2.6 te dokumentave te tenderit.

##### **5. Shoqeria “RSM COMPANY” shpk, per arsye se:**

1.Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7,Kriteret e pergjithshme të kualifikimit pika 1.Ç ku percaktohet shprehimisht se : “Ofertuesi deklaron se:

ç) *personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së”* dhe kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 1.a, per arsye se ne formularin e vetedeklarimit sipas shtojces 8, ne piken A-DEKLARATA PER PERMBUSHJEN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME TE KUALIFIKIMIT, nuk eshte shenuar Znj.Elida Kola,e cila eshte perfaqesuese ligjore e subjektit “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” dege e shoqerise RSM Company, e cila ka firmosur dhe oferten ekonomike dhe formularin e vetedeklarimit.

Pra nuk eshte bere plotesimi i kesaj shtojce sipas kerkesave te saj nga ofertuesi si rrjedhim autoriteti kontraktor nuk mund te beje verifikimet per gjendjen gjyqesore sipas parashikimeve te shkreses te perbashket te APP Nr 1155 Prot dhe Ministrisë të Drejtësisë Nr 1001/1Prot datë 01.02.2019 .

2. Subjekti “Ruge Sinjalistike Mirembajtje & Hidro Company” ka deklaruar se do te mbeshtetet ne kapacitetet e shoqerise “Desaret” sh.p.k per plotesimin e kriterit lidhur me punet e ngjashme, Licenca pika NP.6 dhe Ing.Hidroteknik.

Nga shqyrtimi i preventivit dhe procesverbalit “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” rezulton se të gjitha zërat e preventivit , përvec punimeve te germimit,perfshihen ne kategorine NP-6,si rrjedhim subjekti mbeshtetes do te kryeje pjesen me te madhe te punimeve cka mbeshtetet dhe nga fakti se shoqeria “RSM COMPANY” nuk ka dorezuar pune te ngjashme me objektin e prokurimit pasi edhe per kete mbeshtetet tek shoqeria “Desaret” sh.p.k.

Duke qene se pjesen me te madhe te punimeve do ti kryeje shoqeria Desaret sh.p.k si rrjedhim ajo duhet te kete edhe numrin e punonjesve te nevojshem per kryerjen e ketyre punimeve.

Nga formulari I vetedeklarimit te shoqerise Desaret sh.p.k rezulton se ajo nuk ka deklaruar punonjes.

Ne nenin 84 te LPP parashikohet se “2.Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.”

Gjithashtu ne nenin 90 pika 2 te VKM 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" percaktohet se “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Ne rastin konkret, duke qene se operatori ekonomik ofertuese nuk ka licence per kryerjen e pjeses me te madhe te punimeve,nuk ka kryer pune te meparshme te ngjashme dhe nuk ka ing. Hidroteknik,vleresojme se operatori ekonomik ofertes nuk permbush te pakten 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”

## **6. Bashkimi i operatoreve “ INFINIT ” shpk, dhe “ L.T.E CONSTRUCTION ” shpk, per arsye se:**

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 199% i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht: Ne kontraten e bashkepunimit shoqëria Infnit sh.p.k ka marre persiper te kryeje 60% te punimeve dhe shoqëria LTE Construction ka marre persiper te kryeje 40 % te punimeve.

Shoqëria Infnit sh.p.k per plotesimin e ketij kriteri ka paraqitur:

Kontraten me objekt “Rrugicat” (Perroi I Caprazit+ Kalaja) me vlere 2.640.850 lek. Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme

Kontraten me objekt “Sistemim asfaltim rruge Njesite administrative,Faza II”me vlere 12.396.200 lek,pa tvsh. Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit

Kontraten me objekt “Rikonstruksion I Rruges Koco Glozheni,Dardhe”,me vlere 8.839.330 lek,pa tvsh.

Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit

Kontrata me objekt “Kanal +Ura “ me vlere 1.944.270 lek,pa tvsh nuk ploteson vleren e kerkuar per punent e ngjashme.

LTE ka paraqitur kontraten me objekt “Rikonstruksion i rruges Sofratike-Terihat dhe rrugeve te fshatit” me vlere 38.439.092 lek pa tvsh .Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit.

## **7. Shoqëria “ FLED ” shpk, per arsye se:**

Nje pjese e stafit eshte anagazhuar ne kontraten me objekt ” Ndërtimi i pritave malore dhe mbrojtjeve lumore në njësitë administrative, Bashkia Korçë” ” te lidhur me Bashkine Korce, e cila eshte duke u zbatuar aktualisht.

Konkretisht: Ing e ndertimit dhe ing.hidroteknik

Si rrjedhim nuk permbush kriterin 2.2.3 te dokumenteve te tenderit.

## **8. Shoqëria “ ARTYKA II” shpk, per arsye se:**

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 199% i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht:

Per plotesimin e ketij kriteri jane paraqitur:

Kontrata me objekt : “Ndertimi i ujesjellesit Stropan Devoll” me vlere 29.600.894 lek me date 19.03.2019

Kjo kontrate nuk eshte e vlefshme pasi nuk eshte realizuar gjate pese viteve te fundit .

Kontrata me objekt : “KUZ Njesite administrative viti 2022” me vlere 6.286.110 lek,pa tvsh, eshte me vlere me te vogle se 49 % e vleres te kontrates qe prokurohet ( $12.943.380 \times 49\% = 6.342.256$  )

### **9. Shoqëria “XHENGO” shpk, per arsye se:**

Nje pjese e stafit dhe mjeteve jane te anagazhuara ne kontraten me objekt ” Rikonstruksioni i pjesshem i degës Dunavec–Ventrok në zonën e fshatit Lumalas Nj. A. Bulgarec “, te lidhur me Bashkine Korce, e cila eshte duke u zbatuar aktualisht.

Konkretisht 31 punonjes nga 38 qe ka deklaruar ofertuesi jane te angazhuar ne kontraten ” Rikonstruksioni i pjesshem i degës Dunavec–Ventrok në zonën e fshatit Lumalas Nj. A. Bulgarec

Gjithashtu mjetet: AA021IR,Ko 8365 B dhe ing.i ndertimit dhe ing.hidroteknik.

Si rrjedhim nuk permbush kriterin 2.2.3, 2.2.5 dhe 2.2.6 te dokumenteve te tenderit.

### **10. Shoqëria “INA” shpk, per arsye se:**

1. Nuk ploteson kriterin e vendosur ne dokumentat e tenderit, shtojca 7, pika 2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 199% i vlerës limit të kontratës që prokurohet;

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Konkretisht:

Per permbushjen e ketij kriteri ofertuesi ka paraqitur

1.Kontraten me objekt “Hartimi I projektit dhe zbatimi I punimeve per ndertimin e godines 21 ne zonen zhvillimore 1Maji” . Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit.

2.Kontraten me objekt “Punime civile dhe mekanike” .Kjo kontrate nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit,nuk permban vlerat e zerave te kryer dhe gjithashtu nje pjese e dokumentacionit te paraqitur nuk eshte e perkthyer,nuk ka aktkollaudimi dhe as situacion punimesh.

2.Nje pjese e mjeteve jane te anagazhuara ne kontraten me objekt ” Rikonstruksioni i pjesshem i deges Dunavec–Ventrok ne zone e fshatit Lumalas Nj. A. Bulgarec “, te lidhur me Bashkine Korce, e cila eshte duke u zbatuar aktualisht.

Konkretisht mjetet: AA629NA,ADMT 65.

Si rrjedhim nuk permbush kriterin 2.2.6 te dokumenteve te tenderit.

\*\*\*\*\*

Duke iu referuar procedures se lartpermendur, informojme shoqerine “**ASI INVEST**”*sh.p.k* *adresa: Tiranë, Rruga Xhorxhi Martini, Pallati 17, Ap.5, Hyrja 5*, se oferta e paraqitur me vlerë totale **8.993.999** (*tete milion e nenteqind e nentehjete e tre mije e nenteqind e nentehjete e nente*)*lekë, pa tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.*

Me publikimin e ketij njoftimi, fillojne afatet e ankimit sipas percaktimeve ne nenin 110 te Ligjit Nr. 162/2020, date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SOTIRAQ FILO**